

# RAPORT I FORUMIT TË OZHQ-VE 2023: KOORDINIMI NË MES TË NIVELIT LOKAL DHE QENDROR TË QEVERISJES PËR ZBATIMIN E AGJENDËS 2030





Autor: INDEP

Edituar nga: Ekipi i INDEP

Programi: Zhvillim i Qëndrueshëm

Publikuar: Shkurt 2023

Dizajni: KUKU Creative



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

### **Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, përfaqësojnë opinionin e autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

---

## Përmbajtja:

<i>Hyrje</i> .....	4
<i>Për projektin</i> .....	5
<i>Ngjarja hapëse dhe fjalët hyrëse të përfaqësuesve të nivelit të lartë politik</i> .....	6
<i>Tryeza diskutuese “Mbështetja teknike, monitorimi dhe raportimi për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në nivel kombëtar”</i> .....	9
<i>Tryeza diskutuese “Rëndësia dhe angazhimi i qeverisjes lokale për zbatim dhe monitorim të Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve”</i> .....	10
<i>Rekomandimet kryesore</i> .....	13
<i>Shtojca</i> .....	14

## *Hyrje*

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm është një plan i veprimit për njerëzit, planetin dhe prosperitet. 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) dhe 169 indikatorët e kësaj agjende adresojnë sfidat më të mëdha globale me të cilat përballemi në mijëvjeçarin e fundit, duke përfshirë varfërinë, pabarazinë, ndryshimet klimatike, degradimin e mjedisit, paqen dhe drejtësinë. Adaptimi i kësaj agjende në politikat shtetërore është në baza vullnetare, por që është e pritshme që shtetet të ndërmarrin masa për zbatim të saj, përfshirë ndërtimin e mekanizmave të raportimit dhe përcjelljes së progresit dhe përfshirjen e kornizës së OZHQ-ve në kuadrin e politikave të nivelit qendror dhe lokal. Në vitin 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Rezolutën për Zhvillim të Qëndrueshëm në kuadër të së cilës u themelua edhe Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm si një ndër trupat kryesor drejt promovimit dhe avancimit të kësaj agjende. Një nga sfidat thelbësore në rrugën e adaptimit të Agjendës 2030 në politikat shtetërore është vendosja e targeteve nacionale. Vendosja e targeteve kërkon të dhëna bazë për indikatorët e caktuar në mënyrë që të bëhet një planifikim me hapa konkret në përmbushjen e atyre targeteve.

Për të arritur një avancim me të shpejtë drejt një të ardhme të qëndrueshme kërkohet angazhim gjithëpërfshirës dhe proaktiv nga akterë të rëndësishëm si institucionet qendrore e lokale si dhe akterë të tjerë nga shoqëria civile, sektori privat si dhe academia. E gjithë kjo qasje gjithëpërfshirëse e shoqërisë e cila aplikohet globalisht garanton zbatimin dhe monitorimin e duhur të agjendës. Përfshirja e akterëve kaq të rëndësishëm në avancimin e Agjendës 2030 siguron mbushjen e boshllëqeve të vërejtura dukshëm në nivel vendi për zbatimin e Agjendës, si dhe shpërfaq hapa pasues që duhet të ndërmerren në mënyrë urgjente. Qasja gjithëpërfshirëse e shoqërisë ndër tjerash nënkupton krijimin e një ure bashkëpunuese midis palëve të ndryshme të interesit për të mundësuar një partneritet produktiv dhe hapa konkret drejtë shtyerjes përpara të Agjendës 2030 dhe përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-ve).

Instituti INDEP prej vitit 2018 punon në mënyrë konsistente për të adresuar sfidat dhe problematikat e komunave, institucioneve të nivelit qendror, agjencitë e pavarura dhe akterëve tjerë relevantë për zbatimin e mirëfilltë të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Si pjesë të aktiviteve të përvitshme INDEP organizon forumet me përfaqësues të lartë politik të OZhQ-ve në mënyrë që të promovohet zbatimi i Agjendës 2030 dhe të adresohen sfidat e përvitshme të institucioneve. Forumi i mbajtur këtë vit ka trajtuar dy tema të rëndësishme si dhe në këtë raport janë përmbledhur diskutimet dhe rekomandimet e mbajtura në kuadër të këtij Forumi që është mbajtur si pjesë e

projektit 'SDG Bridge - Ura e koordinimit në mes të nivelit lokal dhe qendror për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë'. Raporti shpalos qëllimin dhe objektivat e ngjarjes që ndërliken me ato të projektit, si dhe rekomandimet e dala nga tryezat do të shërbejnë si një udhërrëfyes në zhvillimin e masave dhe aktiviteteve të mëtejshme në nivel qendror dhe lokal për të ndërmarrë veprime konkrete si dhe hapa për vendosjen e koordinimit ndërmjet institucioneve të nivelit lokal dhe qendror.

## *Për projektin*

Për të avancuar Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm duhet të ketë një komunikim dhe koordinim konsistent dhe sistematik ndërmjet institucioneve të nivelit lokal dhe qendror. Rrethanat e paprecedentë me COVID-19 përfaqësojnë një momentum që mund të përdoret për avancimin e mëtejshëm të OZhQ-ve dhe përfshirjen e të gjithë akterëve të komunitetit që për një kohë të gjatë kanë qenë të lënë anash. Objektiva kryesore e këtij projekti është të përfshijë OZhQ-të në kuadrin e politikave të rimëkëmbjes nga COVID-19 duke promovuar mekanizmat e lokalizimit, zbatimit dhe monitorimit në nivel lokal si dhe krijimin e një ure komunikimi dhe mbështetjeje midis politikave të nivelit qendror dhe nismave lokale. Ndërsa synon këtë, objektivat specifike të projektit synojnë, së pari, ofrimin e njohurive dhe rekomandimeve konkrete për çdo boshllëk të identifikuar të agjendës legjislative dhe pakos së rimëkëmbjes nga COVID-19 dhe avokimin për integrimin e kornizës së zhvillimit të qëndrueshëm brenda dokumenteve të tilla normative. Më pas, specifikisht projekti synon inkurajimin e dialogut politik ndërmjet palëve të interesuara të nivelit qendror dhe lokal për avancimin e agjendës për zhvillim të qëndrueshëm. Poashtu, zgjerimin edhe më tej të kapaciteteve për OZhQ-të, të rrjetit tashmë të krijuar të zyrtarëve komunalë të trajnuar për lokalizimin e OZhQ-ve nga projekti i mëparshëm i INDEP-it. Synim specifik i projektit është edhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut për kornizën e zhvillimit të qëndrueshëm përmes krijimit të podcast-ve të transmetuara në 7 rajone kryesore të Kosovës dhe fushatës në media sociale. Përfundimisht, projekti ka synim mirëmbajtjen dhe pasurimin me të dhëna dhe lajme shtesë platformën e parë për matjen e indikatorëve të OzhQ-ve për Komunën e Drenasit.

Në kuadër të projektit, Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP ka zbatuar disa aktivitete. Fokusi primar ka qenë puna intenzive kërkimore si dhe avokimi. INDEP përmes zhvillimit të takimeve dhe intervistave të rregullta me akterët kryesorë përkatës të nivelit qendror dhe lokal ka pasur për qëllim informimin e duhur të tyre rreth sfidave, nevojave dhe kufizimeve në punën e tyre të përditshme. E tërë kjo ka kontribuar në punën e përgjithshme kërkimore ku në bazë të tyre do të arrihet hartimi i 8 raporteve përkatëse kërkimore. Të gjitha këto raporte do të rekomandojnë dhe avokojnë rreth përfshirjes së

komponenteve të qëndrueshmërisë në planet dhe strategjitë qendrore dhe lokale. Kështu INDEP do të identifikojë temat gjatë zhvillimit të takimeve, të cilat do të portretizojnë temën aktuale të institucioneve të Kosovës në lidhje me Agjendën 2030.

Si pjesë e projektit, është e rëndësishme edhe ngritja e kapaciteteve për zyrtarët komunalë për OZhQ-të. Në bazë të hulumtimeve të mëparshme dhe kontakteve me zyrtarë komunalë në mbarë Kosovën, INDEP ka identifikuar se ka një numër të vogël të trajnimeve të ofruara në lidhje me Agjendën 2030. Andaj, bazuar në disa faktorë, INDEP ka identifikuar 4 komuna që do të angazhohen në këtë aktivitet që janë: Drenasi, Fushë Kosova, Vushtrria dhe Obliqi. Përmes organizimit të tryezave diskutuese është bërë identifikimi i çështjeve më me prioritet për zhvillim të qëndrueshëm me të cilat po përballen komunat kështu që janë identifikuar prioritetet në lidhje me OZhQ-të. Duke synuar vendosjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe lokal në lidhje me OZHQ-të, INDEP ka organizuar poashtu punëtori të përbashkët mes Këshillit Kombëtar të OZHQ-ve dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Duke marrë parasysh impaktin e rrjeteve sociale në përhapjen e informatave tek publiku i gjerë, projekti ka paraparë një fushatë ndërgjegjësuere e përshtatur për qytetarët, për të informuar qytetarët nga komunat e ndryshme për rëndësinë e Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve. INDEP ka publikuar video materiale të cilat janë shpërndarë në kanalet e mediave sociale dhe faqen zyrtare të organizatës, si dhe poashtu ka bërë transmetimin e podcast-ve në disa radiostacione.

### ***Ngjarja hapëse dhe fjalët hyrëse të përfaqësuesve të nivelit të lartë politik***

Forumi Politik nisi me ngjarjen hapëse, e cila u mbajt me 30 Nëntor, dhe pati në përbërjen e saj përfaqësues zyrtarë të institucioneve e organizatave ndërkombëtare e vendore. Folësit në fjalë si të ftuar të ngjarjes hapëse ishin: z. Arbër Vokri, Zv. Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, znj. Fatmire Mulhaxha Kollçaku, Kryesuese e Këshillit Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm, z. Margus Sarapuu, Udhëheqës i



*Figura 1. Fjala hyrëse e zq.Ministrit të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Arbër Vokri*

Ekipit në Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, GIZ Kosova si dhe z. Burim Ejupi, Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Politika Zhvillimore – INDEP, të cilët përshëndetën iniciativën dhe shprehën gatishmërinë për mbështetjen e institucioneve të tyre për avancimin e Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve në vend. Këta folës të nivelit më të lartë që përfaqësojnë institucione e organizata të ndryshme treguan vullnetin e dëshirën për të bashkëpunuar drejtë zbatimit të Agjendës 2030.

Fjalimi i parë i ngjarjes hapëse u mbajt nga z. Arbër Vokri, zv. Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Z. Vokri, tregoi përkushtimin dhe vullnetin e Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, sidomos vitet e fundit për të përmirësuar zbatimin e Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve, në nivel lokal. Z. Vokri theksoi se MAPL do të koncentrojë të gjithë përpjekjet për tu angazhuar edhe më tej në përmirësimin e kushteve për zbatim të Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve, sidomos në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë, si dhe ofrimin e trajnimeve të nevojshme në mënyrë që zyrtarët komunalë të integrojnë OZhQ-të në punën e tyre të përditshme.

Në këtë ngjarje hapëse folësja e dytë ishte znj. Fatmire Mulhaxha Kollçaku, Kryesuese e Këshillit Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm e cila në fjalimin e saj tregoi historikun e formimit dhe të konsolidimit të KNZhQ si dhe tregoi rreth sfidave që ka pasur KNZhQ si trup koordinues për zbatimin e Agjendës 2030 që nga koha e themelimit i tij në vitin 2018. Më pas znj. Mulhaxha - Kollçaku, në fjalimin e saj ka përmendur planin e punës së zbatimit të këtij Këshilli, si dhe fokusin e tij që mbështetet në disa shtylla kryesore si në hartimin e ligjeve, buxhetimin, pastaj mbikqyrjen dhe përfaqësimin, si dhe raportet bashkëpunuese që ka me institucionet tjera e organizatat ndërkombëtare e lokale. Znj. Mulhaxha - Kollçaku më tutje shtoi se Këshilli Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm tani është duke bashkëpunuar me Agjencinë e Statistikave të Kosovës në mënyrë që të formojnë një qendër statistikore brenda Këshillit kështu që do të iu mundësohej deputetëve të kenë qasje më të lehtë në këto të dhëna statistikore, ku krahas zbatimit të përgjithshëm, znj. Mulhaxha - Kollçaku poashtu theksoj se ky Këshill do të punojë me ekspertë të caktuar edhe në indikatorë specifikë, për të arritur një zbatim dhe avancim sa më të mirëfilltë të Agjendës 2030.



*Figura 2. Fjala hyrëse e znj. Fatmire Mulhaxha - Kollçaku*



Përfaqësuesi i GIZ-it, z. Margus Sarapuu, Udhëheqës i Ekipit në Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, GIZ Kosova në fjalimin e tij hyrës përmendi gjithashtu rëndësinë e zbatimit të Agjendës 2030 në Kosovë dhe tregoi rreth mbështetjes që GIZ ofron në këtë proces global për ta ndihmuar zbatimin e saj. Z. Sarapuu përmendi poashtu se puna me Institutin INDEP për zbatimin e kësaj agjende në vitet e fundit, ka filluar pikërisht në nivelin lokal, dhe janë bërë hapa mjaft domethënës në këtë drejtim përkundër faktit që Kosova nuk është e obliguar të zbatojë këtë proces. Ndër tjerash z. Sarapuu theksoi se Agjenda 2030 dhe OZhQ-të janë kornizë që duhet integruar në planet strategjike dhe Kosova duhet të prioritetizoj objektivat specifike kombëtare në të cilat duhet të koncentrojnë punën.



*Figura 3. Fjala hyrëse e drejtorit ekzekutiv të Institutit INDEP*

Drejtori ekzekutiv i Institutit për Politika Zhvillimore - INDEP z. Burim Ejupi, ishte folësi i fundit dhe poashtu një nga bashkëpunëtorët organizues të Forumit Politik të Agjendës 2030. Z. Ejupi theksoi se në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe Këshillin Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm po punojnë në mënyrë që të ngritin vetëdijen dhe kapacitetin human në nivel lokal për lokalizimin e mirëfilltë të OZhQ-ve.

Kështu në fund të fjalimit z.Ejupi tregoi se Instituti INDEP punon në vazhdimësi qysh prej vitit 2018 për zbatimin e kësaj Agjende, dhe do të vazhdoj punën duke dhënë kontribut dhe ndihmë për institucionet e nivelit lokal dhe qendror, deri sa të arrihet progres konkret në avancimin e kësaj Agjende.

## *Tryeza diskutuese “Mbështetja teknike, monitorimi dhe raportimi për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në nivel kombëtar”*

Në tryezën e diskutimit me titull ‘Mbështetja teknike, monitorimi dhe raportimi për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në nivel kombëtar’ ishin të ftuar përfaqësues të nivelit qendror, organizata të huaja ndër-kombëtare dhe përfaqësues nga sektori privat. Kështu për të tentuar përfshirjen e gjithë akterëve relevantë për një zbatim të mirëfilltë të OZhQ-ve dhe Agjendës 2030 në vend. Meqenëse Kosova mbetet ende shumë prapa sa i përket zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në përgjithësi, pjesëmarrësit në diskutim përfaqësonin sektorë të ndryshëm.



*Figure 4. Pamje gjatë panelit 'Mbështetja teknike, monitorimi dhe raportimi për zbatimin e OZhQ-ve në nivel kombëtar'*

Kjo për arsyen e gjithëpërfshirjes dhe mundësisë për të evidentuar sfidat që kanë të gjitha sektoret për zbatim të Agjendës 2030. Vedat Sogojeva nga Zyra për Planifikim Strategjik, diskutoi rëndësinë e një plani të qartë dhe të plotë për zbatimin e qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) në nivel kombëtar. Pjesëmarrësit theksuan nevojën për mbështetje teknike për të arritur dhe përmbushur OZhQ-të në mënyrë efektive. Ilir Berisha nga Agjencia e Statistikave, foli për rëndësinë e monitorimit dhe raportimit të progresit drejt SDGs. Ai vuri në dukje nevojën për mbledhjen dhe analizën e të dhënave të besueshme për të ndjekur progresin drejt SDGs dhe për komunikimin efektiv të kësaj informacioni tek palët e interesuara. Pjesëmarrësi i tretë ishte nga sektori privat prodhues, z. Adnan Vila, i cili diskutoi rolin e sektorit privat në kontribuimin për të arritur SDGs. Ai theksoi nevojën për bashkëpunim midis sektorit privat dhe palëve të tjera të interesuara për të adresuar sfidat e qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë sociale. Znj. Cornelia Schneider, nga OKB-ja, diskutoi kontekstin global të SDGs dhe rëndësinë e zbatimit në nivel kombëtar për të arritur qëllimet globale. Ajo theksoi nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar dhe mbështetje për përpjekjet në nivel kombëtar drejt

SDGs. Në përgjithësi, diskutimi ofroi perspektiva të vlefshme në sfidat dhe mundësitë për zbatimin e SDGs në nivel kombëtar. Pjesëmarrësit theksuan nevojën për mbështetje teknike, monitorim dhe raportim, si dhe bashkëpunim midis palëve të interesuara nga sektorë të ndryshëm.

### *Tryeza diskutuese “Rëndësia dhe angazhimi i qeverisjes lokale për zbatim dhe monitorim të Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve”*

Tryeza diskutuese “Rëndësia dhe angazhimi i qeverisjes lokale për zbatim dhe monitorim të Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve” trajtoi sfidat rreth angazhimit të qeverisjes lokale sa i përket Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve. Gjatë diskutimit u shpалosën përvojat nga disa komuna dhe u theksuan mundësitë për të përmirësuar zbatimin e tyre dhe ngritjen e kapaciteteve duke bashkëpunuar me nivelin qendror.

Tryeza u moderua nga znj. Donikë Beqiri, Hulumtuese e re në Institutin INDEP dhe Koordinatore e Projektit, ku të ftuar për të bashkëbiseduar në tryezën e diskutimit ishin:

znj. Voltana Ademi, ish-Kryetare e Bashkësisë së Shkodrës, z. Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë, z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë si dhe z. Fitim Mulolli, Ekspert i pavarur. Në këtë diskutim u theksuan nevojat dhe praktikat e aplikuara në qeverisjen lokale si në vendin tonë ashtu edhe në vendet fqinje për të arritur në rezultate sa më të kënaqshme të përmbushjes dhe zbatimit të OZhQ-ve në këtë nivel.



*Figura 5. Pamje nga tryeza e diskutimit 'Rëndësia dhe angazhimi i qeverisjes lokale për zbatim dhe monitorim të Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve'*

Një eksperiencë të tillë sa i përket iniciativës të zbatimit të OZhQ-ve në nivelin lokal në vendet fqinje e shpалosi znj. Ademi, ish-Kryetare e Bashkësisë së Shkodrës e cila trajtoi sfidat dhe raportin ndërveprues që ekziston në mes të nivel qendror dhe lokal, ku për shkak të disa reformave që shpesh ndodhin rrjedhimisht ky raport përcillet me mungesë të të dhënave meqë rast të dhënat ekzistuese nuk janë të besueshme dhe natyrisht që edhe vështirë maten. Të gjitha këto sfida e rrisin vështirësinë e lokalizimit të OZhQ-ve

në nivele lokale dhe çdoherë shihet nevoja për një sistem gjithëpërfshirës që operon në monitorimin sa më të saktë të të gjitha të dhënave në kohë reale. Kjo padyshim që e nxit dhe e rrit besueshmërinë tek qytetarët dhe përmirësimet do të jenë evidente nga viti në vit. Duke marr parasysh që në Shqipëri raporti mbi zbatimin e OZhQ-ve bëhet vetëm në nivel kombëtar, kërkohet angazhimi dhe inkuadrimi i të gjithave komunave për të arritur një përmirësim, një përforcim në anën profesionale dhe rritje e kapaciteve raportuese në mënyrë që të shënohet progres në nivelin lokal dhe të arrihet bashkëpunim më efikas në hartimin e raportit në nivelin qendror.

Komuna e Vitisë është njëra ndër komunat që ka implementuar projekte në përputhshmëri me Agjendën 2030 dhe sidomos në vitin e fundit ka shënuar rritje të përkrahjes së aspektit social sidomos për personat me aftësi të kufizuara duke respektuar dinjitetshëm parimin "Mos e le askënd mbrapa". Kështu z. Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë duke parë rëndësinë dhe sfidat në implementimin e projekteve drejt përmbushjes së OZhQ-ve theksoi dhe sugjeroi që para së të punohet në nivel qendror duhet të rritet dhe të përmirësohet angazhimi dhe veprimtaria punuese në nivelin lokal për rezultate sa më të kënaqshme.

Krahas kësaj z. Mulolli në cilësinë e Ekspertit të Pavarur potencoi se OZhQ-të dhe Agjenda 2030 shërbejnë me qëllim të integritit evropian dhe u tregua se raporti i përpiluar nga z. Mulolli është në përputhje me Agjendën e Gjelbër Evropiane dhe OZhQ-të janë tërësisht në përputhje me kompetencat komunale të cilat dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale e natyrisht që e gjithë kjo do të mund të shërbej si një udhërrëfyes i mirë për të ardhmen. Më tutje u tregua se ekzistojnë mjaft sfida në raportim dhe se ky raportimi do të duhet të rregullohej në atë mënyrë që rritet përkushtimi dhe angazhimi në ato komuna që vëllimi i punës është më i madh në krahasim me komunat me më pak punë të cilat e kanë edhe hartimin e raporteve me të lehtë. Për t'u integruar objektivat e Agjendës 2030 sa më mirë në shoqëri dhe në komunitet duhet pikërisht që institucionet dhe komunat të jenë nismëtare dhe të shërbejnë si shembull suksesi se si duhet të zbatohen ato.

Në këtë tryezë u diskutua gjithashtu për rëndësinë e të dhënave të mbledhura në nivelin lokal. Agjenda 2030 ka shumë objektiva dhe për përmbushjen e tyre nevojitet një numër i madh i njerëzve që do të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes në komunitet duke punuar me plane konkrete për realizimin gjithëpërfshirës të këtyre objektivave. Andaj duhet vullnet dhe punë për implementimin edhe të atyre OZhQ-ve që kërkojnë më shumë kohë në realizimin e tyre për shkak të specifikave të tyre. Shumica e objektivave kërkojnë iniciativa dhe përkrahje me të madhe për t'u përfshirë në proceset implementuese të komunave sidomos objektivat që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara e që janë objektiva më të ndjeshëme. Për të plotësuar këto kritere për

këtë kategori duhet një gjithëpërfshirje dhe përkrahje me e madhe në të gjitha institucionet dhe mbështetje për integrimin e barabartë të tyre në të gjitha fushat ashtu si gjithë qytetarët e tjerë. Të gatshëm për përfshirje dhe përkrahje të vazhdueshme e të dinjitetshme të këtyre personave u zotuan përfaqësuesit e komunave të Vitisë dhe Vushtrrisë që ishin të pranishëm në tryezën diskutuese të cilët theksuan se do të ndërmarrin veprime konkrete dhe do të ofrojnë mundësi mbështetëse për krijimin e qasjes sa më të lehtë në të gjitha institucionet dhe inkuadrimit të tyre në vende të punës me qëllim të ngritjes së kapaciteve në komunat e tyre.

Gjatë këtij diskutimi u përmendën edhe sfidat rreth ndryshimeve në nivel lokal apo qendror që kanë në fokus uljen e ndikimit të fatkeqësive natyrore, rreth planeve dhe strategjive të veprimit në rast të fatkeqësive natyrore dhe pasojave që shkaktohen pas përmbytjeve. Gjithashtu si çështje me interes të veçantë dhe njëkohësisht edhe shqetësuese është parë edhe tërheqja e mjeteve të buxhetit të pashfrytëzuar në nivel lokal nga buxheti qendror sipas udhëzimeve të fundit administrative. Në këtë diskutim u tregua se tashmë veçse ekzistojnë strategji dhe plane të veprimit për zonat që janë të rrezikuara nga vërshimet dhe përmirësim të gjendjes pas përmbytjeve, mirëpo problemi kryesor nuk qëndron në zhdukjen e kësaj dukurie pasi që kjo është e pamundur por në reduktimin e pasojave të shkaktuara nga vërshimet në nivel lokal. Pra nga përfaqësuesit e nivelit lokal u theksua sa e rëndësishme është planifikimi dhe zbatimi pa marrë parasysh që kjo kërkon financimin e objektivave strategjike. Po ashtu u kërkuar nga niveli qendror që të angazhohet dhe të fokusohet më shumë në zhvillimin e kapaciteteve ashtu që buxheti komunal duhet domosdoshmërisht të bartet nga viti në vit duke u hartuar udhëzime që nuk e lejojnë tërheqjen e buxhetit të pashfrytëzuar nga niveli qendror me qëllim të shfrytëzimit të tij për përmbushjen e OZhQ-ve dhe jo të pengohet shfrytëzimi i buxhetit për shkak të disa procedurave burokratike të cilat më këtë rast e pengojnë edhe implementimin e projekteve. Në këtë nivel u vlerësua se do të ishte mirë që të përkrahen komunat dhe buxheti i planifikuar për komuna të iu mbetet komunave pasi që projektet implementohen në teritorin e komunave, mirëpo edhe deficitin mbulojnë nga komuna.

Si përfundim nga kjo tryezë diskutuese u theksua se mbështetja e Qeverisë është më se e domosdoshme me qëllim të lokalizimit të Objektivave në përmbushje të Agjendës 2030, ku kontributi nga shoqëritë civile është më se i mirëseardhur. Gjithashtu, duhet ndërhyrë në legjislacion në mënyrë që raportet të mos përpilohen vetëm në mënyrë vullnetare, por institucionet të jenë të obliguara për të përpiluar raportin. Në anën tjetër z. Mulolli në përmbajtje të diskutimit iu bëri thirrje komunave të ndjekin shembullin e komunës së Vitisë, Drenasit, Vushtrrisë të cilat kanë bërë lokalizimin e OzhQ-ve dhe të bëjnë një raportim, një përditësim të sistemit në nivelin lokal përmes performancës lokale duke i përfshirë indikatorët e OZHQ-ve.

## *Rekomandimet kryesore*

Nga tryezat diskutuese u rekomandua që të rritet përkrahja e institucioneve të nivelit qendror dhe u kërkua që kjo përkrahje të bëhet në vazhdimësi jo vetëm në aspekt financiar por edhe me hartimin e kornizave legjislative të nevojshme për të operacionalizuar zbatimin e Agjendës 2030 në mënyrë konkrete. Duke parë rëndësinë dhe sfidat në implementimin e projekteve drejt përmbushjes së OZHQ-ve një rekomandim tjetër u sugjerua që para së të punohet në nivel qendror duhet të rritet dhe të përmirësohet angazhimi dhe veprimtaria punuese në nivelin lokal për rezultate sa më të kënaqshme. Meqë ka shumë objektiva dhe për përmirësimin e gjendjes në komunitet duhet punuar me plane konkrete për realizimin gjithëpërfshirës të këtyre objektivave, duhet dosmosdoshmërisht një numër më i madh i njerëzve në nivel lokal që kontribuojnë në përmbushjen e tyre. Andaj kërkohet vullnet dhe punë për implementimin edhe të atyre OZHQ-ve që kërkojnë më shumë kohë në realizimin e tyre për shkak të specifikave të tyre.

Po ashtu u rekomandua që niveli qendror të angazhohet dhe të fokusohet më shumë në zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve komunal ashtu që buxheti komunal duhet domosdoshmërisht të bartet nga viti në vit duke u hartuar udhëzime që nuk e lejojnë tërheqjen e buxhetit të pashfrytëzuar nga niveli qendror me qëllim të shfrytëzimit të tij për përmbushjen e OZHQ-ve. Në këtë nivel u vlerësua se do të ishte mirë që të përkrahen komunat dhe buxheti i planifikuar në komuna pasi që projektet zbatohen pikërisht në komuna.

U theksua nevoja kryesore për mbështetje teknike, monitorim dhe raportim, si dhe bashkëpunim midis akterëve relevantë nga sektori publik, sektori privat, agjencitë e pavarura dhe organizatat e shoqërisë civile për të arritur një zbatim të mirëfilltë dhe konsistent të OZHQ-ve dhe Agjendës 2030. Të gjitha rekomandimet e nxjerrura nga këto tryeza do të dërgohen te akterët relevantë, të cilat do shërbejnë si udhëzim për zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve relevante koordinuese si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal në mënyrë që të ndërmerren veprime zbatuese konkrete.

# Shtojca Forumi i dytë për OZhQ-të

Agjenda

30 nëntor, Hotel Emerald, Prishtinë

09:45-10:00	<b>Regjistrimi i pjesëmarrësve</b>
10:00-10:35	<p><b>Fjalë hyrëse</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Arbër Vokri, Zv. Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal</li> <li>• Fatmire Kollçaku, Kryesuese e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm</li> <li>• Margus Sarapuu, Udhëheqës i Ekipit në Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit</li> <li>• Burim Ejupi, Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP</li> </ul>
10:35-11:40	<p><b>Panel Diskutimi: “Mbështetja teknike, monitorimi dhe raportimi për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në nivel kombëtar”</b></p> <p><b>Moderator: Dardan Abazi, INDEP</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Vedat Sagonjeva, Drejtor i Zyrës për Planifikim Strategjik</li> <li>○ Ilir Berisha, Drejtor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës</li> <li>○ Cornelia Schneider, Shefe e Zyrës së Koordinatorës së OKB-së për Zhvillim</li> <li>○ Adnan Vila, Zyrtar i CSR-it, Sharrcem</li> </ul>
11:40-11:50	<b>Pauzë për kafe</b>
11:50-12:40	<p><b>Panel Diskutimi: “Rëndësia dhe angazhimi i qeverisjes lokale për zbatim dhe monitorim të Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve”</b></p> <p><b>Moderatore: Donikë Beqiri, INDEP</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë</li> <li>○ Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë</li> <li>○ Voltana Ademi, ish-Kryetare e Bashkisë së Shkodrës</li> <li>○ Fitim Mulolli, Ekspert i pavarur</li> </ul>
12:40-13:30	<b>Përmbyllje e Forumit dhe dreka</b>

Ky projekt financohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

